



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assemble

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 09/2015

Prishtinë, më 24.2.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Besim Beqaj, Sala Berisha-Shala, Raif Qela, Blerim Grainca, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Munguan: Fatmir Rexhepi dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës i ftuar: Lutfi Zharku, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës.

Pjesëmarrës të tjerë: Besnik Hajdari, Xhelil Bekteshi, Fidan Rekaliu, Valmire Maloku, Rexhë Osmanaj, Skender Gashi – Ministria e Infrastrukturës, Dardan Abazi - INDEP, Hatmane Goli – IKPZH, Liridona Llapashtica – Gazeta “Zëri”, Jetmir Bakija – KDI, Bleta Gashi – “Rrokum TV”, Pranvera Musa – “Kosovapress”, Sylejman Blaku – “Kosova sot”.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.02.2015;
3. Raportim i ministrit të Infrastrukturës, z. Lutfi Zharku, lidhur me Strategjinë e Zhvillimit të Rrugëve Nacionale dhe Rajonale;
4. Informatë nga delegacioni i Komisionit lidhur me vizitën zyrtare në Turqi më 5-6 shkurt 2015;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.02.2015

Procesverbali i mbledhjes së datës 10.02.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i ministrit të Infrastrukturës, z. Lutfi Zharku, lidhur me Strategjinë e Zhvillimit të Rrugëve Nacionale dhe Rajonale

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa- Tha se për mbledhjen e sotme kemi ftuar për raportim ministrin e Infrastrukturës, z. Lutfi Zharkun për të na njoftuar lidhur me planet e ndërtimit të rrugëve dhe për çështje të tjera të ministrisë, dhe ia dha fjalën ministrit.

Ministri i Infrastrukturës, z. Lutfi Zharku, fillimisht e njoftoi Komisionin mbi objektivat e Ministrisë së Infrastrukturës në fushën e strategjisë së rrugëve nacionale dhe rajonale. Ai tha se objektiv primar i Ministrisë së Infrastrukturës në sektorin e infrastrukturës rrugore do të jetë integrimi i rrjetit të transportit të Kosovës në kuadër të rrjetit të Transportit të Evropës Juglindore, në të cilin janë të përfshira këto rrugë: Drejtimi rrugor R6 Prishtinë - Hani i Elezit, Drejtimi rrugor R7 Morinë - Prishtinë - Merdare, Drejtimi rrugor N9 Prishtinë - Pejë dhe N2 Prishtinë - Mitrovicë. Në këtë rrjet po ashtu është i përfshirë edhe: Linja hekurudhore 10 Leshak - Hani i Elezit, si dhe Aeroporti i Ndërkombëtar i Prishtinës. Në vazhdim ministri Zharku theksoi se Drejtimi Rrugor R6 Prishtinë - Hani i Elezit është projekti më madhor aktual në të cilin është e angazhuar Ministria e Infrastrukturës, i cili ka filluar në korrik të vitit 2014. Siç e dini kontrata është nënshkruar në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe kompanisë Bechtel-Enka në vlerë prej 599,944,263.55 euro, në të cilën vlerë është përfshirë edhe TVSH-ja. Gjatësia e përgjithshme e projektit është afërsisht 60 km, kurse afati i realizimit të projektit është 42 muaj. Fizikisht projekti është i ndarë në tre seksione: Seksioni i parë (C1) Udhëkryqi i autostradave "IR" dhe "AXh" (R6/R7-N2) - Kycja Konjuh – Kycja Babush; Seksioni i dytë (C2) kycja Babush – kycja Doganaj – Kacanik; Seksioni i tretë (C3) kycja Doganaj Kaçanik – Hani i Elezit. Më tutje z. Zharku shtoi se aktualisht punimet janë duke u zhvilluar në segmentin e parë (C1) të autostradës, gjegjësisht kycja e autostradave "Ibrahim Rugova" dhe "Arber Xhaferi" (R6/R7-N2) me segmentin e rrugës për kycje me udhëkryqin për Gjilan në Veternik dhe drejtimi tjetër deri te Kycja në Konjuh, e të cilat punime përfshijnë hapjen e trasesë, mbushjen, vendosjen e strukturave të rrugës dhe dislokimin e instalimeve të KEK-ut, KOSTT-it dhe Ujësjellësit Rajonal Prishtina, si dhe rrjetit të Hidro-sistemit Ibër-Lepenc, ku paraprakisht është dashur të punohen projektet e dislokimit të instalimeve dhe më pas të miratohen nga ana e kompanive publike. Deri me tani janë hapur 8.5 km trase të ndarë në dy drejtimet që u përmendën me sipër. Si pjesë e kushteve të Kontratës, z. Zharku tha se Bechtel Enka është përgjegjës për punimin e projektit zbatues dhe deri me tani është definuar traseja në segmentin e parë (C1) dhe të dytë (C2), gjegjësisht nga kycja e dy autostradave në Bresje e deri ne Doganaj të Kaçanikut, ndërsa është duke u punuar projekti i trasesë për segmentin e tretë, gjegjësisht pjesën Doganaj – Hani i Elezit. Sa i përket procesit të shpronësimit ai tha se ka përfunduar për segmentin e parë (Kycja R6/R7-lidhja me N2 dhe vazhdimi deri në kycjen në Konjuh) dhe tanimë është marrë edhe Vendimi Final për Shpronësim. Aktualisht është në vijim procesi i shpronësimit për pjesën e mbetur të segmentit të parë (C1) dhe segmentin e dytë (C2), i cili pritet që të përfundojë deri në fund të muajit prill. Proces i shpronësimit për segmentin e tretë (C3) nga Doganajt e Kaçanikut deri në Han të Elezit, duhet të fillojë vitin tjetër, pasi që të aprovohet traseja e autostradës dhe të përgatitet elaborati i shpronësimit. Duke folur për standardet e rrugëve ai shtoi se në segmentin e parë dhe të dytë do të mund të zhvillohet shpejtësia prej 120 km/h, kurse në segmentin e tretë për

shkak të kushteve të terrenit është ulur shpejtësia projektuese në 80km/h. Ministri Zharku foli edhe për autostradën Vërmicë-Prishtinë duke thënë se në drejtimin rrugor R7 gjegjësisht autostradën Morinë-Prishtinë-Merdare, pas lëshimit në qarkullim të segmenteve 1-9 Vërmicë-Prishtinë-Besi, Ministria e Infrastrukturës në bashkëpunim me BERZH-in dhe Bankën Investive Evropiane do të kryej studimin e Fizibilitetit dhe plotësimin e projektit preliminar për segmentin Besi - Merdare (kufiri me Serbinë), pas përfundimit të të cilit do të fillohet me ndërtimin e segmentit të mbetur në gjatësi prej 22 km. Duke marrë parasysh rëndësinë rajonale të këtij projekti në presim që të ketë përkrahje financiare nga ana e Bankës Evropiane për Investime (EIB) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), tha z. Zharku lidhur me segmentin rrugor në fjalë. Në vazhdim të fjalës së tij ministri Zharku informoi anëtarët e Komisionit edhe për segmentet e tjera rrugore. Për Autostradën, gjegjësisht zgjerimi i rrugës nacionale Prishtinë - Gjilan -Dheu i Bardhë, ai tha se është në fazën e parë të projektit preliminar i cili do të definojë trasenë e autostradës së ardhshme dhe koston preliminare të ndërtimit. Për projektin e zgjerimit të rrugës nacionale Prishtinë – Pejë (N9), tha se është duke u punuar me BERZH- in që në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (ĖBIF - Ėestern Balkan Investment Frameëork) të fillohet me plotësimin e Studimit të Fizibilitetit dhe Ndikimit Mjedisor për segmentin Kijevë – Zahaq (32 Km) dhe të bëhet plotësimi i projektit zbatues, si parakusht për fillimin e implementimit të projektit. Kohëzgjatja e planifikuar është 3 vjet, gjegjësisht deri në fund të vitit 2018. Sa i përket vazhdimit të projektit të zgjerimit të rrugës nacionale Prishtinë – Mitrovicë (N2), tha se gjatë tri viteve të ardhshme, Ministria e Infrastrukturës do të ketë në dispozicion edhe afër 50 milionë euro kredi nga Banka Islamike për Zhvillim, Fondi Saudit për Zhvillim dhe Fondi i OPEC-ut për zhvillim. Procedurat për fillimin e projektit pritet që të fillojnë në fund të këtij viti, ndërsa projekti pritet të përfundojë në fund të vitit 2018. Në besojmë se deri në fund të këtij viti do të përfundojnë punimet në projektin aktual deri në Stanovc, pasi që tanimë nga Qeveria është marrë vendimi përfundimtar për shpronësimin e parcelave të cilat kanë ndikuar në këtë zvarritje të punimeve, shtoi z. Zharku. Përpos projekteve të cekura më lart ai tha se tanimë kemi filluar edhe procedurat e prokurimit për punimin e projektit të zgjerimit të rrugës rajonale Prishtinë – Podujevë dhe besojmë se gjatë këtij viti do të kemi pasqyrën e qartë mbi koston dhe kohën e përfundimit të kësaj rruge. Po ashtu, ai tha se në fund të vitit të kaluar është nënshkruar kontrata për hartimin e projektit kryesor për zgjerimin e rrugës rajonale Komoran – Drenas – Skenderaj për të cilën është ndarë edhe buxheti në shumë prej 4.5 mil EUR që të fillojnë punët gjatë këtij viti. Krahas kësaj ministri Zharku tha se do të vazhdohet me projektet e filluara më herët për ndërtimin e rrugëve të reja siç është rruga nacionale Deçan – kufiri me Malin e Zi (Plavë), rruga Mushtisht (Suha Rekë) – Jezerc (Ferizaj), rruga Loxhe – Kerstovc – Resuje – Qollapek, rruga Piranë – Mamushë, rruga Pollatë – Reçicë – Demahmetaj, rruga R 221 Istog - Skenderaj, etj., si dhe në përgatitjen e projekteve për rrugët rajonale Duhel – Shtime – Ferizaj – Gjilan dhe Pejë – Deçan – Gjakovë – Prizren. Në fund të fjalës së tij përveç projekteve të cekura më parë ai tha se Ministria e Infrastrukturës do të jetë e përkushtuar po ashtu në : programin e rehabilitimit të rrugëve nacionale dhe rajonale të cilat janë ne kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës; bashkë financimin me komuna për përmirësimin e gjendjes së rrugëve lokale; ndërtimin e rrugëve transite dhe ndërtimin e rrugëve kufitare; mirëmbajtjen e rrugëve nacionale dhe rajonale përfshirë sinjalistikën horizontale dhe vertikale; si dhe hartimin e projekteve për investime kapitale.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se do të ishte mirë të shohim projektin e fizibilitetit të autostradës për Gjilan dhe mundësinë e lidhjes me autostradën për Ferizaj. Kryetari Mustafa kërkoi nga ministri të shqyrtojë mundësinë që në bisedë me Bechtel Enka në vend të segmentit Doganaj-Hani i Elezit të ndërtohet autostrada për Gjilan. Ai theksoi se punimet në rrugën Prishtinë-Mitrovicë kanë shkaktuar shumë vështirësi në qarkullim. Në vazhdim Mustafa theksoi se do të dëshironim të kemi një “Road Map” strategji për planifikimin e ndërtimit të rrugëve në 5 apo 10 vitet e ardhshme. Ai tha se disa rrugë janë aprovuar një ditë para miratimit të

buxhetit, dhe shtoi se ndërtimi i rrugëve duhet të bazohet në arsyeshmërinë e investimit dhe ndikimit më të madh social dhe ekonomik. Me theks të veçantë ai tha se ne nuk mund të hyjmë në investime pa e ditë koston e ndërtimit. Kryetari Mustafa kërkoi nga ministri më shumë informata për hekurudhat dhe terminalët doganore.

Pal Lekaj, Tha se u përmendën shumë rrugë, por që nuk janë të përcjella me vija buxhetore. Në vazhdim Lekaj tha se Gjakova që tri vjet ka kërkuar të ndihmohet në ndërtimin e tri hyrjeve të qytetit, por ende nuk ka asgjë, derisa projekti ka mbetur në sirtar të Komunës. Më tutje z. Lekaj duke tha se sikur e keni anashkaluar Gjakovën, kemi pasur vetëm premtime, por që nuk janë realizuar, dhe përmendi urën e Rakovinës duke thënë se që tri vjet nuk keni mundur ta ndërtoni. Ai tha se nuk morëm asnjë informatë lidhur me shifrat e shpronësimit, dhe po ashtu kërkoi më shumë informata për hekurudhën me Shqipërinë. Ai kërkoi nga ministri që të mos fillohen rrugët e të mbesin pa u ndërtuar, po ashtu ai tha se shënjimi dhe ndriçimi ka shumë probleme.

Blerim Grainca, e pyeti ministrin se sa është rentabile rruga për Shkup? A është çmim standard i ndërtimit dhe a ka arsyeshmëri financiare? Po ashtu Grainca pyeti se a ka kontraktuar Ministria ndonjë kompani për mbikëqyrjen e autostradës për Shkup? Lidhur me hekurudhat Grainca pyeti se a ka Ministria ndonjë model të financimit? Ai kërkoi më shumë informata rreth licencave që jep Ministria për linjat e autobusëve. Po ashtu kërkoi të shikohet më shumë mundësia e ndërtimit të rrugës Ferizaj-Gjilan.

Visar Ymeri, Tha se infrastruktura duhet të lidhet me modelin ekonomik dhe orientimin ekonomik të vendit. Një plan strategjik dhjetëvjeçar për rrugët, duke përfshirë edhe termet financiare na mundëson t'i ikim vendimmarrjeve ad-hoc shtoi Ymeri. Ai tha se shumica e projekteve që përmendi ministri janë projekte të kaluara. Duke iu referuar informatës nga ministri se Kontrata me "Bechtel" për autostradën Prishtë-Hani i Elezit është rreth 600 milionë euro Ymeri pyeti ministrin se deri në sa mundet të shkojë kjo vlerë e kontratës? Ai e pyeti ministrin se a do ta bëni publike kontratën me "Bechtel Enka"? Po ashtu Ymeri pyeti edhe për variantet e ndërtimit të autostradës me tunel apo pa tunel? Për rrjetin hekurudhor Ymeri tha se është në gjendje të keqe, duke shtuar se kompania ka pasur disa tentativa për rehabilitimin e hekurudhave, dhe pyeti ministrin se a do t'i jepni prioritet hekurudhave duke përfshirë edhe lidhjen me Shqipëri? Në fund, Ymeri pyeti pse në avio-kompanitë që fluturojnë në Kosovë nuk bëjnë njoftimet në aeroplan edhe në gjuhën shqipe?

Besim Beqaj, Tha se për rrugën për Mitrovicë këtë vit janë 50 milionë euro nga fondacioni, procesi ka shkuar shumë ngadalë, dhe pyeti cila do të jetë dinamika e ndërtimit të kësaj rruge? Lidhur me rrugën Prishtinë-Pejë ai tha se dinamika e punimeve është duke shkuar ekstrem ngadalë, dhe shtoi se kompanitë kanë obligim t'i riparojnë shkëputjet e mos t'i lihen kohës. Për segmentin Zahaq-Kijevë ai kërkoi përsheptimin e procedurave. Në vazhdim Beqaj kërkoi mbikëqyrje më të madhe punimeve, dhe kërkoi të sqarohet afati i kryerjes së punëve se a është me ditë pune apo ditë kalendarike. Më tutje ai foli edhe për hekurudhat duke thënë se në SETO janë të regjistruara linjat për Shqipëri dhe Mal të Zi, dhe shprehi dilemat e tij lidhur me arsyeshmërinë e hekurudhave. Ai tha se ne jemi duke ndërtuar rrugë të reja mbi rrugë të vjetra, duke thënë se është praktikë e gabuar dhe kërkoi që të ndërtohen rrugë të reja të tjera nga ato ekzistuese dhe kjo do të shkarkonte edhe trafikun. Ai foli edhe për monopole eventuale duke thënë se aty ku pretendohet se ka monopol të bëhet analizë dhe nëse ka të thuhet se ka e nëse nuk ka të thuhet se nuk ka. Në fund Beqaj kërkoi nga ministri më shumë informata lidhur me dinamikën e projekteve, rolin e fondeve dhe bashkëpunimin me institucione financiare.

Sala Berisha – Shala, pyeti se a është planifikuar mirëmbajtja e autostradës për Vërmicë? Duke shtuar se ka pasur shembje të dheut në pjesë të autostradës, dhe po ashtu pyeti se kur do të ndërtohen objektet përcjellëse të parapara në autostradë? Lidhur me hekurudhat ajo tha se duhet

të dihet kost-benefiti dhe të shikohet mundësia e investimeve me ndihmën e donacioneve. Më tutje Berisha-Shala tha se duhet të sqarohen monopolet në terminale doganore, homologim, etj.

Enver Hoti, Tha se shumë projekte kanë filluar me shpejtësi të madhe, kanë zgjat procedurat e ndërtimit, dhe kërkoi nga ministri mbikëqyrje më të madhe dhe pa studim fizibiliteti. Ai kërkoi nga ministri të bashkëpunojë me Komunat dhe t'i shohë të gjitha Komunat njëjtë. Ai po ashtu kërkoi nga ministri sqarime për monopolet në terminalet doganore.

Raif Qela, Tha se pjesa më e madhe e shqetësimeve janë rrugët. Lidhur me infrastrukturën rrugore ai tha se pjesa më e madhe e rrugëve janë funksionale, dhe është koha të zvogëlohet dinamika e investimeve në rrugë në mënyrë që të zgjerohen investimet në sektor të tjerë zhvillimor. Në vazhdim Qela tha se kontrolli i cilësisë së rrugës është jo i mirë dhe kërkoi të bëhet më shumë në kontrollin e cilësisë së rrugës. Më tutje ai kërkoi që para se të fillojë ndërtimi i rrugëve të gjendet rrugë alternative për qarkullim. Në fund ai kërkoi që në projektbuxhetin e ardhshëm të përfshihet ndërtimi i rrugës që lidh Trepçën me disa fshatra veriore si Kushtovë, Cerajë, etj. dhe te trajtohen si rrugë rajonale.

Ministri i Infrastrukturës, z. Lutfi Zharku – tha se ndërprerja e autostradës për Han të Elezit nga Doganaj dhe transferimi në rrugën për Gjilan mund të paraqet probleme kontraktuale pasi që kontrata është e mbyllur. Rruga Prishtinë-Mitrovicë ka pasur vështirësi në shpronësim dhe Qeveria tashmë ka marrë vendimin për shpronësim dhe deri në fund të vitit do të kryhet pjesa e kontraktuar deri në Stanovc, ndërsa pjesa tjetër është në proces të rregullimit të financimit dhe deri në fund të vitit mendojmë të fillohet me punë tha z. Zharku. Sa i përket Hekurudhës me Shqipëri ai tha se jemi në procedurë të studimit të fizibilitetit. Lidhur me mos përfshirjen e projekteve në vija buxhetore ai tha se ka projekte të tilla por në momentet e ndërtimit do të gjenden fondet. Ura e Rakovinës sipas informatave tha se para fillimit të pranverës ura pritet të lëshohet në funksion. Më tutje ministri Zharku, duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve tha se shpronësimi nuk është çështje e Ministrisë së Infrastrukturës, dhe sqaroi se Ministria përgatit elaboratin e shpronësimit, ndërsa shpronësimin e bënë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, derisa vlerën e shpronësimit e përcakton Ministria e Financave, dhe shtoi se në shumën 600 milionë euro të autostradës për Han të Elezit nuk është i përfshirë shpronësimi. Sa i përket shënjimit ai tha se gjatë vitit do të vazhdohet me shënjim. Lidhur me pyetjen se a është çmim standard çmimi i kontraktuar ministri Zharku tha se konkurrenca ka qenë e lirë dhe janë zhvilluar procedurat e rregullta deri në kontraktim. Më tutje z. Zharku tha se mbikëqyrja në autostradën “Ibrahim Rugova” ka filluar me vonesë, ndërsa për autostradën për Han të Elezit “Arbën Xhaferi” mbikëqyrësi është kontraktuar me kohë dhe këtë mbikëqyrje e bën kompania “Hill International”. Për rrugët tjera ai informoi deputetët se mbikëqyrja është bërë nga zyrtarët e Ministrisë, por jemi në proces të shqyrtimit që këtë mbikëqyrje ta bëjnë kompanitë jashtë vendit. Ndryshimet në vlerën e kontraktuar për autostradën për Han të Elezit mund të shkojnë deri në 10% në pajtim me ligjin e prokurimit, ndërsa sa i përket publikimit të kontratës, ne jemi të hapur për këdo që dëshiron të shohë kontratën, përveç nëse me ndonjë dispozitë është përcaktuar që është fshehtësi afariste tha ministri Zharku. “Segmenti 3” a do të jetë me tunel apo pa tunel, ai tha se varet cila zgjidhje konsiderohet më e favorshme, propozimin për variantin e bën Bechtel-i ndërsa vendos Komisioni ndërministror, kurse kostoja mbetet e njëjtë me apo pa tunel. Për hekurudhat ministri Zharku tha se kompetencat janë të shpërndara, pasi që ndërmarrjet publike “Infrakos” dhe “Trainkos” janë nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, pjesa e hekurudhës për Prizren nuk është në funksion. Linja hekurudhore Hani i Elezit – Leshak në bashkëpunim me BERZH-in pritet të bëhet rehabilitimi i kësaj linje në faza të caktuara dhe të përfundojë më 2019, shtoi z. Zharku. Më tutje ai tha se nuk kemi ndonjë analizë se cila rrugë duhet ndërtuar këtë vit apo vitin tjetër, por ato që janë në buxhet ato do të ndërtohen, megjithatë kemi strategjinë e transportit multimodal ku parashihen orientimet e zhvillimit të transportit. Lidhur me përdorimin e gjuhës së vendit të fluturimit në njoftimet në aeroplan ministri tha se

sipas legjislacionit Evropian avio-kompanitë nuk janë të obliguara të njoftojnë pasagjerët në gjuhën e vendit të fluturimit por i përdorin gjuhët ndërkombëtare që fliten më shumë. Për rrugën Prishtinë-Mitrovicë mendojmë që gjatë këtij viti me zgjedh kompaninë për ndërtimin e pjesës tjetër deri në Mitrovicë, ndërsa për rrugën Prishtinë-Pejë janë tri kontrata, ka probleme me komunitetin dhe jemi në kontakt me Komunën e Pejës për të gjetur mënyrën më të mirë. Sqaroi se për mirëmbajtjen e autostradës së Kombit është e kontraktuar mirëmbajtja në vlerë prej 2 milionë euro, ndërsa mirëmbajtjen si rezultat i shembjes e rregullon “Bechteli” në kuadër të garantimit. Pranimi teknik për këtë autostradë është bërë, ndërsa për objektet përcjellëse në autostradë është duke vazhduar kompletimi i procedurave që të shkohet me partneritet publiko-privat shtoi z. Zharku. Sa i përket trajtimit pa diskriminim të Komunave për përkrahje në investime rrugore ai tha se do t’i trajtojmë të gjitha Komunitetet njëjtë sidomos ato që janë më dobët në aspektin buxhetor. Lidhur me transparencën ai tha se jam i përkushtuar të jem transparent, ndërsa tha se ka vërejtje në kontrollin e cilësisë dhe për këtë jemi në proces të kontraktimit të mbikëqyrjes. Për rrugën nga Trepça në drejtim të fshatrave Kushtovë dhe Cerajë, ministri tha se do të shohim me rishikimin e buxhetit mundësitë për këtë rrugë. Në shqetësimin e deputetëve për ekzistimin e monopoleve në terminale, homologime, etj, z. Zharku sqaroi se terminalët doganorë nuk janë në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës, por terminalët e mallrave janë në kompetencë të kësaj ministrie, janë 7 apo më shumë terminale dhe rrjedhimisht nuk ka monopol. Ministri i mëparshëm në bazë të rekomandimeve të një Komisioni brenda ministrisë ka pezulluar përkohësisht dhënien e licencave për terminale të tjera sepse është konsideruar se nuk ka nevojë për më shumë terminale të tilla, sqaroi ai. Lidhur me Qendrën e homologimit tha se është vetëm një e tillë dhe jemi në proces të analizimit nëse duhet të shtohet numri i qendrave të tilla apo analizimin e nevojës së ekzistimit të tyre. Lidhur me qendrat e atestimit ministri Zharku tha se ato kanë për detyrë vlerësimin teknik të automjeteve në rast të ndryshimit të karakteristikave të automjeteve. Në fund lidhur me monopolet tha se ekziston edhe Autoriteti i Konkurrencës që ka autorizimin të konstatojë ekzistencën e monopoleve.

Blerim Grainca, kërkoi sqarime nga ministri për disa ankesa që kanë bërë banorët e fshatit Babush ku shqetësimi i banorëve është se autostrada për Ferizaj e ndan fshatin, dhe po ashtu pyeti se çka po ndodh me aeroportin e Gjakovës?

Raif Qela, e pyeti se heqja dorë nga porti i Shëngjinit a është çështje ekonomike apo ekzistojnë arsye tjera?

Sala Berisha-Shala, Tha se në studimin e fizibilitetit të korridoreve rrugore është me rëndësi studimi gjeologjik i atyre korridoreve rrugore, mundësia e ekzistimit të resurseve natyrore në ato korridore dhe pyeti se a janë të përfshirë ekspertët e gjeo-shkencave në këto projekte?

Ministri Lutfi Zharku, duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve tha se ankesat e banorëve të fshatit Babush janë se autostrada po e ndan fshatin, megjithatë sipas vijës së autostradës fshatin Babush e ndan vetëm pak, dhe natyrisht se autostrada prek fshatra e vende tjera dhe shmangiet eventuale paraqesin problem të madh në ndërtimin e autostradës dhe krijohen precedentë për raste të tjera, ndërsa për aeroportin e Gjakovës tha se nuk kam ndonjë koment për sot. Ndërsa lidhur me portin e Shëngjinit tha se është çështje ekonomike arsyeja pse nuk e ka marrë Kosova këtë port sqaroi z. Zharku. Lidhur me përfshirjen e ekspertëve të gjeo-shkencave në projektet e korridoreve rrugore tha se të gjithë ekspertët e fushave relevante janë të përfshirë në studimin e fizibilitetit dhe projekteve rrugore.

Kryetari falënderoi Ministrin për përgjigjet e dhëna dhe shtoi se duhet t’i ikim praktikës projekto-ndërto.

Pas debatit Komisioni, njëzëri, nxori këto

Konkluzione

1. *Ministria e Infrastrukturës të bëjë një studim sektorial për rrugë, i cili duhet me i paraprirë strategjisë së zhvillimit të rrugëve dhe të vendosen si prioritet dhe, kjo të bëhet deri në shtator.*
2. *Komisioni mbështet orientimin e Ministrisë për hekurudhën me Shqipërinë dhe inkurajon Ministrinë të vazhdojë angazhimet për ndërtimin e kësaj hekurudhe.*
3. *Komisioni inkurajon Ministrinë që të luftojë monopolet dhe të gjejë zgjidhje sa më shpejt që është e mundur.*

4. Informate nga delegacioni i Komisionit lidhur me vizitën zyrtare në Turqi më 5-6 shkurt 2015

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me vizitën në Turqi, të organizuar nga Parlamenti Evropian për pjesëmarrje në seminarin ndër-parlamentar më temë “Siguria e energjisë, eficienca e energjisë dhe ndërlidhja me Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë” me anëtarë të parlamenteve të vendeve të Para – Anëtarësimit, Parlamentit Evropian dhe Turqisë, nga data 5 – 6 shkurt 2015, në Ankara të Turqisë. Ai tha se në emër të Kuvendit të Kosovës kemi paraqitur nivelin e zhvillimit të sektorit energjetik. Po ashtu ai shtoi se kemi pasur kontakte edhe me anëtarë të Komisioneve të vendeve të tjera dhe kemi pasur një pritje edhe nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Turqi.

Visar Ymeri, pjesëmarrës në vizitë, tha se derisa kemi qenë në vizitë në Turqi jemi takuar me Eduard Shalsin, kryetar i Komisionit për energji në Shqipëri, dhe jemi pajtuar të kemi një takim të përbashkët në Kosovë të të dy Komisioneve të energjisë të Shqipërisë dhe Kosovës në muajin mars.

Kryetari, tha se jam takuar më zotin Shalsi në Tiranë javën e kaluar në konferencën e organizuar nga NPC dhe e kemi lenë që në muajin prill të mbajmë një mbledhje të përbashkët.

5. Të ndryshme

Pal Lekaj, Tha se kemi pranuar një kërkesë të shoqatës së ndërmarrjeve që merren me argjilë, dhe propozoi që të trajtohet kjo kërkesë.

Visar Ymeri, propozoi të ftohet ministri i Zhvillimit Ekonomik të raportojë lidhur me termocentralin “Kosova e re”.

Raif Qela, Tha se Kombinati Trepça ka mbetur pa licencë për operim për shkak të mungesës së Bordit të KPMM-së dhe propozoi të përshpejtohet plotësimi i Bordit të KPMM-së.

Kryetari, Tha se jemi duke pritur propozimet e Qeverisë për anëtarë të Bordit të KPMM-së. I njoftoi anëtarët e Komisionit se për mbledhjen e radhës në rend dite do të jetë diskutimi dhe raportimi i institucioneve përgjegjëse lidhur me Zbatimin e Rekomandimeve të Kuvendit të datës 27.06.2013, për faturimin e shpenzimit të rrymës elektrike për muajin janar 2013.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa